



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1106/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vjosa Smajlaj, kandidate për anëtare të kuvendit komunal, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Prizren, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Prishtinë, për shkak të manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e parregullt ankesa e Vjosa Smajlaj, kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013, nga Vjosa Smajlaj, kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga subjekti politik (AAK), dega në Prizren, në të cilën pretendon se i janë manipuluar votat nga ana e komisionereve dhe kërkon rinumërimin e votave në këto Vendvotime 2030A/01R, 2030A/02R, 2069A/01R, 2069A/01D, 2043A/01D, 2015A/02R, 2015A/03R, 2015A/04R, 2015A/05D, 2018A/02R, 2018A/01R.

PZAP-i, shqyrtoi ankesën, gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lëndës PZAP-i, konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e parapara në bazë të nenit 3.6 pika d) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e ku thuhet se të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese, vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës, andaj për këtë arsye duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave

dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr.1106/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Berit Osmani**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.